



## R KUVENDI I SHQIPËRISË

### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 1.10.2019

Dokument parlamentar

### **RAPORT PËR**

### **PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN””**

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i Lumit Lana – zhvillim urban”, në mbledhjen e tij të datës 1 tetor 2019.

Projekti “Shtrati i Lumit Lana – Zhvillimi urban” do të mundësojë krijimin e një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmbytjeve në këtë zonë, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës. Projekti përfshin punime përgjatë përafërsisht 1.8 km të lumit Lana dhe plotëson rehabilitimin e lumit të kryer përgjatë përafërsisht 16 km në rrjedhën e sipërme të zonës së Projektit në qytetin e Tiranës.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i Lumit Lana – zhvillim urban” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, në shumën prej 2,4 milionë eurosh.

Projekti “Vazhdimi i bulevardit “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri” dhe rehabilitimi i lumit të Lanës nga Ura Teknologjike deri te kryqëzimi me rrugën “Teodor Keko”” ka për qëllim zgjatimin e bulevardit nga Ura Teknologjike deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratis të lumit të Lanës po për këtë segment. Projekti përfshin zgjerimin e dy bulevardeve, të cilat janë paralele me lumin Lana, përkatësisht Bulevardet "Gjergj Fishta" dhe "Bajram Curri", duke kontribuar në rigjenerimin urban përmes pajisjes së zonës rrethuese të lumit me infrastrukturë urbane dhe përmirësimin e integritetit dhe lidhjes së dy brigjeve të lumenjve me Qytetin.

Zona që ndikohet nga projekti shtrihet në një sipërfaqe prej 110 ha. Kryesisht ndërtimet përgjatë lumit të Lanës janë ndërtime informale banimi 1, 2 dhe 3 kate, të vetëndërtuara dhe me kushte minimale të banimit. Këto banesa kanë mangësi të theksuara në lidhje me infrastrukturën sociale dhe ato inxhinierike. Lidhjet me rrjetin e ujit të pijshëm shpesh mungojnë dhe ato furnizohen me ujë pusi, i cili mund të jetë i ndotur.

Për realizimin e këtij projekti duhen:

- krijuar një shtrat me regjim hidraulik eficient për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe duke krijuar hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës deri në kryqëzimin me rrugën Teodor Keko;
- zgjatuar bulevardet paralel me lumin me të gjithë infrastrukturën e nevojshme si sinjalistikën, disiplinimin e ujërave të bardha dhe të ndotura, ndriçimin, telekomunikacionin, peizazhin si dhe lidhjen me infrastrukturën ekzistuese;
- ndërtuar 2 ura mbi shtratin e ri të lumit për nevojat e zhvillimit urban;
- kryer punime pastrimi në shtratin e lumit Lana, rregullimin dhe ri-drejtimin e rrjedhës së lumit për të shmangur problemet e përmytjeve në këtë zonë.

Vlera e grantit në shumën 2,4 milionë eurosh do të shërbejë për bashkëfinancimin e këtij projekti duke plotësuar vlerën e një kredie të akorduar nga BEI në shumën 8 milionë euro.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përfron ndonjë legjislacion të BE-së.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë shqyrtimit të projektligjit deputetët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me trajtimin e familjeve të cilëve do t'u shemben shtëpitë në kuadër të realizimit të këtij projekti dhe që nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë, shpjeguan elementët kryesor të kësaj marrëveshjeje granti, si dhe iu përgjigjën deputetëve në lidhje me ecurinë e projektit dhe vazhdimin e tij, i cili do të realizohet me anë të këtij financimi.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në ecurinë e deritanishme të këtij projekti, si dhe në mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme për trajtimin e familjeve të cilat humbasin shtëpitë për shkak të këtij projekti.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për mundësimin e plotësimit të rehabilitimit të lumit Lana edhe në segmentet që mbulon ky financim i ri.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

**Besnik BARAJ**

Relator

**Niko PELESHI**

Kryetar